



BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 12, datë 27.02.2015

Për

**“SHPREHJEN E APROVIMIT PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM
BANKËS SË SHQIPËRISË, TË HAPËSIRËS PUBLIKE PËRRETH SAJ”**

Në zbatim të nenit 6, pika 2, nenit 7, pika 2, nenit 8, nenit 32, shkronja “e” dhe nenit 33, pika 4 të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 për “Pronat e paluajtshme të Shtetit” (i ndryshuar); ligjit 8744, datë 22.2.2001 për “Transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr.143, datë 18.01.2012 për “Miratimin e listës paraprake (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tiranë, të Qarkut të Tiranës”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.650, datë 31.07.2013 për “Miratimin e listës së pjesshme të inventarit (pjesa e tretë, e katërt dhe e pestë) të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Tiranë, të Qarkut të Tiranës”, si dhe bazuar në kërkesën e Bankës së Shqipërisë për kalimin në përdorim të saj të territorit të zënë nga trotuaret dhe rrugës së shërbimit përreth ndërtesës së Bankës së Shqipërisë në sheshin “Skënderbej” me qëllim sistemimin e tyre në funksion të krijimit të një imazhi sa më pozitiv si për ndërtesën e këtij institucioni, ashtu edhe për qytetin e Tiranës, me propozim të disa anëtarëve të Këshillit Bashkiak:

V E N D O S I:

1. Shprehjen e aprovimit për dhënie në përdorim të përkohshëm pa kundërshtim Bankës së Shqipërisë, të hapësirës publike përreth saj sipas planimetrisë teknike bashkëlidhur, me qëllim sistemimin e kësaj hapësire për krijimin e një imazhi sa më pozitiv.
2. Afati i dhënies në përdorim të jetë deri në përfundimin e procedurave ligjore për kalimin e kësaj sipërfaqeje në administrim të Bankës së Shqipërisë, nga Këshilli i Ministrave, pa ndryshuar destinacionin e saj për përdorim publik.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

ALDRIN DALIPI